



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.167/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “S...” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati F.M. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim V.J. nga Prishtina, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.203/16 e datës 16/07/2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **18/01/2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditëses “S...” me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.203/16 e datës 16/07/2020.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor III.EK.nr.203/16 e datës 16/07/2020, në pikën I të dispozitivit ka vendosur të refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses “S...” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material të shkaktuar nga zjarri me datën 31/10/2015, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 38,003.09 euro, me kamat ligjore duke filluar nga data e paraqitjes së padis 07/04/2016 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në afat kohore prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar

dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të aprovoj kërkesëpadinë apo të njëjtin ta prish dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja S... me seli në Prishtinë, pran Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 07/04/2016, ka paraqitur padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S..." me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se e paditura i ka lëshuar paditëses polisen e sigurimit-zjarri dhe rreziqet shtese me nr.... për periudhën kohore nga data 09/09/2015 e deri me datën 08/09/2016 dhe me këtë polis të sigurimit janë mbuluar rreziqet themelore siç janë: zjarri, eksplozimi, rrufeja, rënia e avionëve dhe pjesëve të tyre. Mandej në arsyetim të aktgjykimit theksohet se me datën 31/10/2015 ka ndodhur ngjarja me të cilën është shkaktuar zjarri në objektin e siguruar dhe me procesverbalin e hulumtimit të zjarrit e datës 03/11/2015 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme është vërtetuar se deri te zjarri ka ardhur aksidentalisht nga kabulli punues dhe ashkave të makinës-shpuese gjatë montimit të reklamës dhe ky shkak sipas kushteve të përgjithshme të pronës është paraparë përjashtimi i mbulimit të rrezikut nga zjarri utilitar (zjarr përdorimi ose shërbimi) si dhe rastet kur dëmi shkaktohet me dashje apo nga pakujdesia e rend e të siguruarit e që në rastin konkret paditësja me mjete të pa përshtatshme ka vepruar duke qenë në dijeni për kualitetin e objektit dhe duke mos ju përshtatur kushteve të materialeve. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit

të atakuar, duke u bazuar në nenin 136 dhe nenin 923.1 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse me provat e administruara nuk është vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë sepse me polisen e sigurimit të zjarrit dhe rreziqeve shtesë, me numër ... e datës 09/09/2015, vërtetohet fakti se palët kontraktuese kanë paraparë mbulimin e sigurimit nga zjarri, eksplozimi, rrufeja, rënia e avionëve dhe pjesëve të tyre e po ashtu pjesë përbërëse e kësaj polise është paraparë të jetë edhe Kushtet e përgjithshme të sigurimit nga Zjarri dhe Rreziqet Shtese, Kushtet e veçanta etj., e që në rastin konkret i siguruari-paditësja e ka konfirmuar se e ka kuptuar përmbajtjen e kushteve si dhe është pajtuar me to. Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se zjarri ka ndodhur me datën 31/10/2015 dhe i njëjti është shkaktuar si pasoj e ramjes se ashklave në kablrat punues për shpuarjen e vrimave për vendosjen e reklamës nga punëtorët e paditëses, e cila gjendje faktike gjen mbështetje edhe në raportin e punuar nga komisioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme-Agjencia e Menaxhimit Emergjent në përbërje prej: A.G. dhe M.B., të cilët kanë konstatuar se intenziteti i ndezjes së zjarrit ishte shumë i shpejt nga materiali i ndezshëm.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se në rastin konkret është zbatuar drejt e drejta materiale sepse me nenin 950 par.1 të LMD-së është parapare: *Siguruesi ka për detyrë t'i shpërblejë dëmet e shkaktuara rastësisht ose për faj të kontraktuesit të sigurimit të siguruarit ose të shfrytëzuesit të sigurimit, përveç nëse për dëmin e shkaktuar ky detyrim i tij është përjashtuar shprehimisht me kontratën e sigurimit.* Sipas kushteve të përgjithshme të kontratës për sigurim ndërgjyqësit në mënyrë shprehimore kanë paraparë përjashtimin nga mbulimi i sigurimit nëse dëmi në objektin e siguruar shkaktohet nga zjarri utilitar dhe nga pakujdesia e rënd. Me provat e administruara u vërtetua bindshëm se paditësja gjatë punimeve në objektin e siguruar përveç se ka përdorur zjarrin utilitar, ajo ka treguar edhe pakujdesi të rëndë (ekstreme) sepse paditësja ka qenë me vetëdije të plotë se zjarri mund të shkaktohet lehtësisht, megjithatë nuk i ka marr masat adekuate për mbrojtje nga zjarri dhe si rezultat objekti i siguruar për momentin është përfshirë nga zjarri duke u shkaktuar dëme materiale. Në kuptim të kësaj dispozite rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të pa themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkëlqje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.167/20, me datën 18/01/2021

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v